



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.541/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Enis Ajvazi me vendbanim në Gjermani, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.541/2021, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Enis Ajvazi me vendbanim në Gjermani për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Enis Ajvazi të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 06 shkurt 2021, për mos përfshirjen në listën e votuesve jashtë vendit për zgjedhjet e 14.02.2021, mirëpo me këtë apel, nuk ka paraqitur asnjë pretendim, vetëm se në ankesë ka bashkangjitur disa dokumente.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, pasi që konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i apelit nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-së, me të cilën ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se ne rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së, me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesja e apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122, apelimet zgjedhore, paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se: Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë

prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në KZAP:

- a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
- b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
- c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
- d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe
- f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është i palejuar, nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.541/2021 më datën 03.03.2021

Kryesuesi i Panelit
Adrian Konushaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.